



# BULETIN INFORMATIV

Janar - Qershor 2009

**KOMISIONI PËR EKONOMI, TREGTI, INDUSTRI,  
ENERGJETIKË, TRANSPORT DHE TELEKOMUNIKACION**



Kuvendi i Republikës  
së Kosovës



Janar - Qershor 2009





## Fushëveprimtaria e Komisionit

### PËRMBAJTJA

**FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT**

**MBLEDHJET E KOMISIONIT**

**SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE**

**SHQYRTIMI I RAPORTEVE VJETORE TË  
AGJENSIONEVE TË PAVARURA**

**DËGJIMET PUBLIKE**

**MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJEVE**

**RAPORTIMI I MINISTRAVE NË  
KOMISION**

**STATISTIKA**

**PËRBËRJA E KOMISIONIT**

**K**omisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në kuadër të fushëveprimtarisë së tij, angazhohet për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fusha të ekonomisë, tregtisë, industrisë, energjetikës, transportit dhe telekomunikacionit në Kosovë, të cilat udhëhiqen nga Institucionet e Republikës së Kosovës.

Për konceptimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive ekonomike ndërmjet Kosovës e autoriteteve tjera, Komisioni për ETIETT bënë rekomandime për Kuvendin, Ministrinë përkatëse etj., në krijimin e infrastrukturës ligjore për një ambientit më të sigurt për investime, për marrëveshje tregtare, për koncesione në infrastrukturë, energjetikë, resurse minerale dhe çështjet të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e këtyre degëve ekonomike.



## Plani i Punës 2009

Në bazë të Strategjisë Legjislative të Qeverisë, në fillim të vitit 2009, Komisioni për ETIETT ka miratuar Planin e Punës në bazë të të cilit është duke i zhvilluar aktivitetet e tij.

Plani i Punës për gjashtëmujorin e parë ka paraparë që Komisioni: të angazhohet në ndërtimin e infrastrukturës ligjore nën juridiksionin e tij, të grumbulloj informata përmes dëgjimeve publike dhe formave tjera të



bashkëpunimit me qëllim të hartimit sa më të mirë të projektligjeve, të formojë nën grupe punuese sipas nevojës, të monitorojë implementimin e zbatimit të së paku një ligji, të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e Kosovës dhe organizatat relevante ndërkombëtare, të punojë në ngritjen e cilësisë së punës dhe bashkëpunimit intern duke

duke përfshirë edhe stafin mbështetës dhe të përmirësojë vizibilitetin e Komisionit dhe komunikimin me qytetarë.

### Mbledhjet e Komisionit

Komisioni për ETIETT, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, ka mbajtur gjithsej *20 mbledhje të rregullta*. Gjatë këtyre takimeve, Komisioni ka shqyrtuar Projektligjet që kanë qenë në procedurë, raportet e agjensioneve të pavarura dhe kërkesat tjera të parashtruara nga Qeveria si dhe agjensionet tjera. Për të gjitha projektligjet Komisioni ka përgatitur raporte me amendamente, të cilat i janë rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Për të qenë sa më efektiv, Komisioni ka formuar *9 grupe punuese* për secilin Projektligj, të cilat kanë përgatitur amendamente për komisionin.

Me ftesë të Komisionit në takime kanë prezantuar përfaqësues të Qeverisë dhe agjensione tjera qeveritare dhe jo qeveritare. Gjithashtu, takimet e Komisionit kanë qenë të hapura dhe janë përcjellur nga monitorues vendor dhe ndërkombëtar si dhe mediat. Në mbledhjet e Komisionit janë zhvilluar debate dhe diskutime brenda standardeve demokratike.





## *Shqyrtimi i projektligjeve*

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2009, Komisioni për ETIETT, ka shqyrtuar gjithsejt *10 projektligje*. Ato janë:

### ***Të përfunduara:***

- Projektligji për Shpronësim;
- Projektligji për Ndryshim dhe Plotësim i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit;
- Projektligji për Zonat Ekonomike;
- Projektligji për Naftë dhe Derivate të Naftës;
- Projektligji për Konformitet;

### ***Në procedurë:***

- Projektligji për Gazin Natyror;
- Projektligji për Standardizim;
- Projektligji për Masat Anti Dumping;
- Projektligji për Miniera dhe Minerale;

### ***Të kthyera te sponsorizuesi:***

- Projektligji për Rezervat Shtetërore të Mallrave
- Projektligji për Rregullatorin për Ujëra dhe Mbeturina

Gjatë shqyrtimit të këtyre projektligjeve, Komisioni ka ftuar sponsoruesit e këtyre projektligjeve (përfaqësuesitë e Qeverisë) dhe ka pranuar ekspertizë të kanë ofruar organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

## **Shqyrtimi i raporteve vjetore të agjensioneve të pavarura**

Gjatë këtij gjashtëmuorin, Komisioni ka shqyrtuar raportet vjetore të punës për vitin 2008 për katër agjensione të pavarura. Agjensionet që kanë paraqitur raportet e punës për vitin 2008 para Komisionit janë:

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) dhe Agjencioni Kosovar i Pronave (AKP). Përveç, përfaqësuesve të ART-së, përfaqësuesitë e agjencive tjera kanë prezantuar raportet e tyre para Komisionit, me ç'rast kanë përmbushur obligimet ligjore.





## Dëgjimet Publike

Qëllimi i organizimit të dëgjimeve publike nga komisionet është grumbullimi i sa më shumë informatave dhe përfaqësimit sa më të madh, duke përfshirë edhe grupet e interesit. Është me interes që në këto takime të përfshihen sa më shumë përfaqësues të grupeve që preken drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë nga ligji apo çështja për të cilën mbahet një dëgjim publik.



Komisioni për ETIETT, në gjashtëmujorin e parë, ka mbajtur një dëgjim publik për Projektligjin për Zonat Ekonomike. Në këtë dëgjim kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përfaqësues të odave ekonomike vendore dhe të huaja, përfaqësues të biznesit dhe të shoqërisë civile. Ky dëgjim është organizuar dhe mbështetur nga NDI.

## Monitorimi i zbatimit të ligjeve

Duke u bazuar në nenin 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni ka autoritet të mbikëqyr zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës ose nga Ministria përkatëse. Qëllim i mbikëqyrjes është verifikimi i zbatueshmërisë së ligjeve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në fushën që e mbulon ligji.

Në bazë të këtij autoriteti, Komisioni për ETIETT, në vitin 2008, kishte filluar të monitoroj zbatimin e *Ligjit për Rrugët*. Në kuadër të monitorimit të këtij ligji, Komisioni ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, takim me përfaqësuesit e Komunës së Gjakovës, përfaqësuesit e Komunës së Mitrovicës dhe përfaqësuesit e Prishtinës. Gjatë vizitës në komunën e Gjakovës, Komisioni ka vëzhguar edhe punimet në rrugën e Dushkajës.





Pas përmbylljes së vizitave në terren dhe grumbullimit të të dhënave të nevojshme, në muajin Qershor 2009, Komisioni ka hartuar raportin me rekomandime, të cilin e ka miratuar dhe i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit që ta vendos në rend dite për njëjërën nga seancat e radhës për shqyrtim.

## **Raportimi i ministrave në Komision**

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, para Komisionit për ETIETT, kanë raportuar ministrat dhe zyrtarët e tjerë të ministrive, fushat e të cilëve mbulohen nga ky komision. Ata janë:

- Ministri i Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit, z. Fatmir Limaj ka raportuar për zbatimin e Ligjit për Rrugët;
- Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, z. Lutfi Zharku, ka arsyetuar Projektligjin për Tregti me Naftë dhe Derivatet e saj;
- Ministri i Energjisë dhe Minierave, znj. Justina Pula Shiroka, ka raportuar Projektin e Qeverisë së Kosovës “Kosova e Re”.

### **Statistika**

- Mbledhje të komisionit	20
- Projektligje të shqyrtuara	10
- Grupe punuese të formuara	10
- Takime të grupeve punuese	30
- Monitorimi i ligjeve	1
- Vizita në terren	2
- Raportimi i ministrave në takime	4
- Dëgjime publike	1


# PËRBËRJA E KOMISIONIT



Myzejene Selmani – AKR  
Kryetare e Komisionit



Ethem Çeku – AAK  
Zëvendëskryetar i Parë



Slobodan Petrovic – SLS  
Zëvendëskryetar i Dytë



Kaqusha Jashari – PDK  
Anëtare



Safete Hadërgjonaj – PDK  
Anëtare



Haki Shatri – LDK  
Anëtar



Fatmir Rexhepi - LDK  
Anëtar



Sala Berisha – Shala – PDK  
Anëtare



Zef Morina – LDK  
Anëtar



Berim Ramosaj – LDD  
Anëtar



Mufera Shinik – 7+  
Anëtare





## Kontaktet

### *Marrëdhëniet me Publikun*

Sherif Konjufca                      Shef i Seksionit

*Zyra N - 08, Kati përdhes*

038 211 186

[sherif.konjufca@assembly-kosova.org](mailto:sherif.konjufca@assembly-kosova.org)

### *Stafi mbështetës i Komisionit*

Hasan Tahiri                      Administrator i zyrës

038 211 297

[hasan.tahiri@assembly-kosova.org](mailto:hasan.tahiri@assembly-kosova.org)

Advie Morina                      Zyrtare e Lartë Ligjore

038 211 185

[advie.morina@assembly-kosova.org](mailto:advie.morina@assembly-kosova.org)

Armend Ademaj                      Zyrtar Ligjor

038 213 801

[armend.ademaj@assembly-kosova.org](mailto:armend.ademaj@assembly-kosova.org)

Besim Haliti                      Nëpunës Administrativ

038 211 838

[besim.haliti@assembly-kosova.org](mailto:besim.haliti@assembly-kosova.org)

### *Zyrtare nga NDI që mbështet Komisionin*

*Zyra N - 409, Kati IV*

Blerina Uka                      Zyrtare Legjislative

038 212 532

[blerinauka5@gmail.com](mailto:blerinauka5@gmail.com)

044 513 655

### *Webfaqja e Kuvendit*

[www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org)

## Përkrahur nga:

